



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.48/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli- kryesues, Ramush Bardiqi dhe Hidajete Gashi Alaj - anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Subjektit Politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, të paraqitur kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 7 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.06.2026, merr këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET PJESËRISHT E BAZUAR ankesa ZP.Anr.48/2026, e datës 10.06.2026 e parashtruar nga subjekti politik Lista Serbe, paraqitur kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 7 Qershor 2026, ashtu që **URDHEROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), respektivisht QKN në Ranillug, që një (1) fletëvotim në vendvotimin Nr. 3503/01 në Ranillug, të vlerësohet si i vlefshëm dhe i njëjti të rinumërohet dhe të përfshihet në rezultatin zgjedhor.

II. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e ankesës së subjektit politik Lista Serbe, paraqitur kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 7 Qershor 2026, me të cilën është kërkuar që katër (4) fletëvotime të shpallen të vlefshme lidhur me vendvotimin Nr. 3503/01 në Ranillug.

A r s y e t i m

Me datën 10.06.2026, PZAP-i ka pranuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik Lista Serbe, në të cilën pretendohet se me datën 09.06.2026 në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), gjatë numërimit të votave nga vendvotimi 3503/01, në mes orës 10:30 dhe 11:30, kanë vërejtur se votat e Listës Serbe u shpallën të pavlefshme me arsyetimin se subjekti politik ishte shënuar me këto simbole Ë, =, %, ♥. Në këtë rast konsiderojnë se janë dëmtuar, sepse në fletëvotime shihet qartë qëllimi i votuesit dhe se në këtë mënyrë po shtrembërohet vullneti i votuesve.

Si dëshmi në ankesë kanë bashkangjitur fotografi të fletëvotimeve.

Në përgjigjen në ankesë KQZ ka deklaruar se bazuar në nenin 3, paragrafi 1.38 të Ligjit Nr. 08/1.228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Qendra Komunale e Numërimit (QKN) është institucioni përgjegjës për numërimin e fletëvotimeve në mënyrë transparente, në prani të vëzhguesve dhe personave të tjerë të akredituar, Po ashtu, sipas nenit 5, paragrafi 1.4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 Qendra Komunale e Numërimit, ndër funksionet e QKN përfshihet edhe numërimi i fletëvotimeve dhe votave të kandidatëve të subjekteve politike. Në lidhje me vlefshmërinë e fletëvotimeve, neni 16, paragrafi 2 i Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 2024 Votimi, Numërimi Në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, përcakton se një votë është e vlefshme kur është shënuar vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë vullneti i votuesit. Në të kundërtën vota konsiderohet e pavlefshme në rastet kur: 1. Janë shënuar më shumë se një subjekt politik; 2, Nuk është shënuar asnjë subjekt politik; 3, Janë shënuar vetëm kandidatët, por jo subjekti politik; 4, Qëllimi i votuesit nuk është i qartë. Për më tepër, sipas nenit 16, paragrafi 6 të Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024, nëse anëtarët e KVV-së nuk arrijnë të pajtohen lidhur me atë se a është vota e vlefshme apo i pavlefshme, atëherë kryesuesi merr vendimin përfundimtar përkitazi me atë votë dhe këtë rast e evidenton në librin e votimit. Në Procedurën e votimit dhe numërimit në vendvotim, të miratuar nga KQZ me dt. 23.05.2026, nr. 01/955-2026, parashihen shembujt e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 7 qershor 2026. (Shih procedurat e votimit dhe numërimit në vendvotim Për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 07.06.2026. KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, të komunës së Ranillugut, gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen nga organet e drejtësisë.

Si dëshmi KQZ ka bashkëngjitur vendimin për Procedurën e Votimit dhe Numërimit në Vendvotim.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës gjeti se:

- **Ankesa është pjesërisht e bazuar.**

Paneli vlerësoi se pretendimet e parashtruara në ankesë se gjatë numërimit të votave nga vendvotimi 3503/01, në mes orës 10:30 dhe 11:30, fletëvotimet për subjektin politik Lista Serbe u shpallën të pavlefshme me arsyetimin se subjekti politik ishte shënuar me këto simbole Ë, =, %, ♥, Paneli i vlerësoi se janë pjesërisht të qëndrueshme, pasi që nga provat e bashkëngjitur në ankesë është vërejtur se nga pesë fletëvotimet që janë shpallur të pavlefshme në QKN, paneli ka gjetur se njëri nga fletëvotimet e shpallura të pavlefshme nuk hyn në kategorinë e fletëvotimeve të pavlefshme sepse shënjimi i subjektit politik që ishte në listën e fletëvotimit ka qenë në rregull dhe është vërejtur qartë synimi i votuesit, ku parashihet edhe me nenin 16 paragrafin 2 të Rregullores Zgjedhore nr.12/2024 “Vota është e vlefshme, kur votohet vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë qëllimi i votuesit”, pika 2.1 “në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, vota konsiderohet e vlefshme nëse votuesi ka votuar për një (1) subjekt politik; 2.2. “në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, vota konsiderohet e pavlefshme, në rastet kur: 2.2.1. “Kur votohet më shumë se një subjekt politik”; 2.2.2. “kur nuk votohet asnjë subjekt politik”; 2.2.3. “kur votohen vetëm kandidatët dhe jo subjekti politik”; 2.2.4. “kur qëllimi i votuesit nuk është i qartë, sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim”.

Nga kjo gjendje faktike, Paneli ka vlerësuar se nga pesë fletëvotimet e shpallura të pavlefshme, njëri prej tyre është i plotësuar në mënyrë të rregullt, ashtu që është shenjëzuar katrori i subjektit politik përkatës, andaj ky fletëvotim duhet të jetë në kategorinë e fletëvotimeve të vlefshme.

Andaj konform nenit 118 paragraf 1 të LZP, PZAP ka vendosur si në pikën I të këtij aktvendimi.

Në katër fletëvotimet e tjera të shpallura të pavlefshme përveç që ka qenë i shënjuar katrori i subjektit politik, janë vërejtur edhe shënjime tjera si: vija dhe pika në katrorët apo emrat e subjekteve tjera në atë fletëvotim, rrjedhimisht këto fletëvotime hynë në kategorinë e fletëvotimeve të pavlefshme, pasi që qëllimi i votuesit nuk është i qartë, sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim e paraparë me nenin 16 paragrafi 2 pika 2.2 nen pika 2.2.4 të Rregullores Zgjedhore nr.12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit.

Prandaj, Paneli vlerësoi se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur veprime që kanë shkelur dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së, të cekur si më lart.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, lidhur me pikën II të ankesës nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, nenit 118 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës lidhur me nenin 16 paragrafin 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024, si dhe nenin 13 paragrafi 12 pika 12.1 të Rregullores Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave Nr.01/2025, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZP.Anr.48/2026, datë 12.06.2026

Kryesuesi i Panelit
Kujtim Pasuli



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.